

20251603539

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR BIBLIOTEKAT

Neni 1

Në Ligjin për bibliotekat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15 dhe 39/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21), në nenin 8 në paragrafin (2) fjalët "organi i administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e kulturës" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit".

Në paragrafin (3) fjalët "ministri" zëvendësohen me fjalët "ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Në paragrafin (4) fjalët "ministri" zëvendësohen me fjalët "ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Neni 2

Në nenin 9 në paragrafin (2) fjalët "Organi i administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e kulturës (në tekstin e mëtejme: Ministria)" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit".

Neni 3

Në nenin 10 në paragrafin (4) fjala "Ministria" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit", dhe fjalët "ministri" zëvendësohen me fjalët "Ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Në paragrafin (5) fjalët "ministri" zëvendësohen me fjalët "ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Në paragrafin (6) fjalët "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe procedurën e Marrëdhënies së Punës në shkallë të dytë" zëvendësohen me fjalët "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Marrëdhënie e Punës, Procedurë dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallën e Dytë".

Neni 4

Në nenin 12 në paragrafin (9) fjalët "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë" zëvendësohen me fjalët "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrjes Inspektuese në Shkallë të Dytë".

Neni 5

Në nenin 21 në paragrafin (5) fjalët "ministri", zëvendësohet me fjalët "ministri i Kulturës dhe Turizmit".

Neni 6

Në nenin 29 në paragrafin (4) fjala "ministri", zëvendësohet me fjalët "ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Neni 7

Në nenin 37 në paragrafin (1) fjalët "Ministria", zëvendësohen me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit".

Neni 8

Neni 48 ndryshohet si vijon:

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt zgjedhorë profesional nga neni 47 i këtij ligji, me propozim të komisionit shqyrtues e kryen Ministri i Kulturës dhe i Turizmit.

(2) Komisioni shqyrtues përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të emëruar nga Ministri i Kulturës dhe i Turizmit me mandat dy vjeçar. Kryetari dhe anëtarët e komisionit recensues mund të emërohen si shkencëtarë me titullin Doktor i Shkencave në fushën e bibliotekarisë ose persona me titull profesional bibliotekar-këshilltar. Me rastin e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit shqyrtues, do të merret parasysh parimi i përfaqësimit të duhur dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Komisioni shqyrtues:

- përcakton nëse personat i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit profesional dhe për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional të përcaktuar me këtë ligj dhe me aktin nga neni 49-a të këtij ligji;

- e vlerëson dhënien e provimit profesional nga neni 47 paragrafi (1) i këtij ligji;

- kryen pikëzimin nga neni 47 paragrafi (2) nënparagrafi 2 dhe paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji dhe

- i paraqet Ministrit të Kulturës dhe të Turizmit propozim për zgjedhje/moszgjedhje, përkatësisht rizgjedhje/mosrizgjedhje në titull profesional.

(4) Komisioni shqyrtues propozimin nga paragrafi (3) nënparagrafi 4 i këtij neni, ia paraqet ministrit të Kulturës dhe të Turizmit në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për zgjedhje, ose rizgjedhje në titull profesional.

(5) Propozimi nga paragrafi (3) nënparagrafi 4 të këtij neni përmban: të dhënat biografike për kandidatin, vlerësimi i plotësimit të kushteve për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhja në titull profesional, vlerësimi për zgjedhje në titull profesional sipas rezultateve të provimit profesional dhe vlerësimi për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional në përputhje me pikët e marra nga akti në nenin 49-a të këtij ligji.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional zgjat më së shumti dy muaj.

(7) Ministri i Kulturës dhe i Turizmit në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së propozimit nga komisioni shqyrtues do të marrë vendim për zgjedhje/moszgjedhje, përkatësisht rizgjedhje/moskryerjen e rizgjedhjes në titull profesional.

(8) Kundër vendimit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të deklarohej ankesë në afat prej 15 ditëve në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrjes Inspektuese në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e prolongon realizimin.

(9) Punët administrative-teknike të Komisionit shqyrtues i kryen Ministria e Kulturës dhe e Turizmit.”

Neni 9

Në nenin 4-a) fjala "ministri" zëvendësohet me fjalët "ministri i Kulturës dhe i Turizmit".

Neni 10

Në nenin 51 në paragrafin (1) fjala "Ministria" zëvendësohet me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit”.

Në paragrafin (2) fjala "Ministria" zëvendësohet me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit”.

Në paragrafin (3) fjala "Ministria" zëvendësohet me fjalët "Ministria e Kulturës dhe e Turizmit”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.